



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:232672  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05464334

Ac.nr.9967/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses NLB Bank me seli në Prishtinë, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga A. G. dhe E. S., zyrtarë ligjor në kompaninë Debt Loan Recovery, kundër të paditurve J. T. nga Prishtina i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Valmir Zhjeqi nga Avokatura Invicta L.L.C ne Prishtinë, si dhe M. A. nga Prishtina i cili përfaqësohet nga avokat Rrahim Ajeti nga Prishtina, me objekt kontesti kthim i kredisë, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurit M. A. nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.958/2015 datë 08.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET e pa themeltë ankesat e paditëses NLB Bank me seli në Prishtinë, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.958/2015 datë 08.08.2021, në pikën I, VËRTETOHET.

II. APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurit M. A. nga Prishtina, NDRYSHOHET aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.958/2015 datë 08.08.2021 në pikën II sa i përket shpenzimeve të procedurës, ashtu që tani gjykohet si në Vijim: Detyrohet paditësja NLB Bankë me seli në Prishtinë që të paditurit M. A. nga Prishtina, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 513 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.958/2015 datë 08.08.2021, ka vendosur: I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpafia e paditëses NLB Bank me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit J. T. dhe M. A., që të dy nga Prishtina, që paditëses t'ia paguajnë në emër të kthimit të kredisë së papaguar, shumën prej 3278.10 euro me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive të borxhit nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, SI E PABAZUAR.

### II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë: paditësja për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditëses dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu kundër pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i padituri M. A. nga Prishtina, në afatin ligjorë ka parashtruar ankesë për shkak të vendimit për shpenzimet procedurale, duke propozuar gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet paditësja në pagesën e shpenzimeve të procedurës për të paditurin M. A. nga Prishtina.

Përgjigje në ankesën e paditëses ka parashtruar i padituri J. T., për mesë së cilës e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e paditëses si të pa bazuar duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që ta refuzojë ankesën e paditëses dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, në ankesa, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Ankesa e të paditurit M. A. nga Prishtina është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja NLB Bank, me seli në Prishtinë, me datë 02.04.2015, në Gjykatën e shkallë së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurve J. T. dhe M. A. që të dy nga Prishtina, për kthimin e kredisë, vlera e kontestit 3,491.85 euro,.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur shqyrtimin kryesorë dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.958/2015 datë 08.08.2021, me të cilin ka refuzuar kërkesë padinë e paditëses, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar: Gjykata fillimisht gjen se në rastin konkret, raporti juridiko-detyrimor mes palëve ndërgjyqëse është krijuar me datë 26.11.2003, si datë e lidhjes së kredisë, mospërmbushjën e të cilës e pretendon e paditura, andaj ligj i aplikueshëm në këtë çështje kontestimore është Ligji mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së i vitit 30 mars 1978, tani e tutje referuar si LMD). Meqenëse të paditurit, përgjatë shqyrtimit kryesor janë thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit, Gjykata, në kuptim të Nenit 360.3 të Ligjit për Marrdhëniet e Detyrimeve, në të cilin përcaktohet se *“Gjykata nuk mund ta përfill parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë”* fillimisht ka shqyrtuar çështjen e parashkrimit të kërkesës objekt i këtij kontesti.

Më tej ka arsyetuar se: Me Nenin 371 të LMD-së përcaktohet se *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*. Me Nenin 360.2 përcaktohet se *“Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mund të kërkoj përmbushjen e detyrimit”*. Ndërsa me Nenin 361 përcaktohet se *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas datës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Po ashtu me Nenin 389 të LMD-së përcaktohet se *“Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se anulohet masa e siguruar ose e ndërmarrë e ekzekutimit apo e sigurimit”*. Në rastin konkret, i padituri i parë ka marrë kredinë nga paditësja ndërsa i padituri i dytë është ofruar si garantues për kredi me datë 26.11.2003, ndërsa afati për kthimin e kredisë të marrë ka qenë 24 muaj pas marrjes së saj, pra me datë 26.11.2005. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi, i është drejtuar Gjykatës me padi për realizimin e kërkesës për kthimin e kredisë me datë 02.04.2015.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata, vlerëson së në kuptim të Nenit 360.2 të LMD-së, afati i parashkrimit lidhur me kërkesën e paditësit ka filluar të rrjedhë ditën e parë pas datës kur i padituri ka rënë në vonesë, pra nga data 27.11.2005 dhe se në kuptim të Nenit 371 të LMD-së kërkesa në fjalë ka arritur parashkrimin pesë vjet pas kësaj date, pra me 27.11.2010. Andaj, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, pasi që në kuptim të Nenit 371 të LMD-së ka kaluar afati 5 vjeçar nga data e arritshmërisë së kërkesës brenda të cilit afat paditësi është dashur t’i drejtohet Gjykatës për realizimin e kërkesës së pretenduar, pasi që padia është paraqitur dhjetë vite pasi që i padituri ka rënë në vonesë. Në anën tjetër, Paditësi, ka dështuar të argumentoj para Gjykatës, se afati i parashkrimit lidhur me kërkesën që është objekt i këtij kontesti është ndërprerë përmes pohimit nga ana e të paditurit apo me ndërmarrjen e veprimeve nga vet paditësi për ndërprerjen e këtij afati. Në shqyrtimin gjyqësor, paditësja ka pretenduar se e njëjta ka iniciuar procedurë përmbartimore lidhur me kërkesën në fjalë qysh në vitin 2005, dhe se gjatë gjithë kohës ka kërkuar përmbushjen e detyrimit nga ana e të paditurve, andaj edhe kërkesa në fjalë nuk është parashkruar pasi që afati i parashkrimit është ndërprerë.

Më tej ka theksuar se: Nga provat e administruara, Gjykata vërtetoi faktin se në procedurën përmbartimore të iniciuar sipas kreditorit, Kasabank, trashëgimtare ligjore e së cilës është këtu tani paditësja NLB Bank nga Prishtina, kundër debitorëve- J. T., M. A. si dhe H. K., të lejuar sipas Aktvendimit E.nr. 1240/05, është marrë Aktvendim PPP.nr. 834/16 i datës 10.10.2017 me

të cilin është aprovuar prapësimi i debitorit M. A. ndërsa Urdhri Përmbarimor E.nr.1240/05 i datës 11.01.2006 është shfuqizuar. Në lidhje me këtë, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se ndaj Aktvendimit në fjalë, paditësja nuk ka ushtruar të drejtën e Ankesës, dhe i se njëjti ka marrë formën e prerë. Në kuptim të Nenit 389 ku përcaktohet se *“Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se anulohet masa e siguruar ose e ndërmarrë e ekzekutimit apo e sigurimit”*. Rrjedhimisht veprimet e paditëses (konkretisht të paraardhëses së paditëses) në procedurën përmbarimore, të zhvilluar pranë Gjykatës Komonale në Prishtinë me shenjen E.nr.1240/05, nuk kanë sjellë deri tek ndërprerja e afatit të parashkrimit për kërkesën objekt i këtij kontesti, pasi që Urdhri Përmbarimor për lejimin e përmbarimit sipas propozimit të paditësit në procedurë përmbarimore është shfuqizuar dhe rrjedhimisht në kuptim të Nenit 389 të LMD-së konsiderohet se afati i parashkrimit ka vazhduar të rrjedhë pa pësuar ndërprerje. Bazuar në Nenin 319 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se *“secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta”*, e meqenëse në rastin konkret paditësja nuk i ka ofruar gjykatës prova mbi të cilat do t'i mbështeste pretendimet e saj për ndërprerje të afatit të parashkrimit, Gjykata nuk arriti të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata e shkallë së parë, për mënyrën e vendosjes është bazuar në nenin 360.2, 361 dhe 389 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm në pjesën vërtetuese, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar palët ankuese me ankesa.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallë së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kur ka vendosur që ta refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar për shkak të parashkrimit, pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezulton një gjendje e tillë. Sipas nenit 371 të LMD-së së vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit

të raportit juridik, i cili parasheh që *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*. Me Nenin 360.2 të po të njëjtit ligj, parashihet se: *“Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mund të kërkoj përmbushjen e detyrimit”*. Ndërsa me Nenin 361 të po të njëjtit ligj përcaktohet se *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas datës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Andaj, duke qenë se nuk ka qenë kontestuese mes palëve se i padituri i parë ka marrë kredinë nga paditësja ndërsa i padituri i dytë është ofruar si garantues për kredi me datë 26.11.2003, ndërsa afati për kthimin e kredisë të marrë ka qenë 24 muaj pas marrjes së saj, pra me datë 26.11.2005, ndërsa paditësja i është drejtuar Gjykatës së shkallës së parë me padi për realizimin e kërkesës për kthimin e kredisë me datë 02.04.2015, që do të thotë se e njëjta padinë e ka parashtruar pas skadimit të çdo lloje afati të parashkrimit, përkatësisht 9 viteve nga dita kur i padituri kishte për obligim në shlyerjen e detyrimit sipas kontratës mbi huan, apo më mirë të themi nga dita e parë kur paditëses i është bërë e arritshme kërkesa.

Gjithashtu gjykata e Apelit analizoj pretendimet ankimore të paditëses në lidhje me atë se e njëjti e ka ndalë parashkrimin në momentin që i është drejtuar gjykatës me propozim për përmburim të borxhit, por të njëjtat pretendime nuk u morën për bazë, pasi që ndërprerja e parashkrimit është e paraparë në mënyrë të qartë se si bëhet dhe atë sipas nenit 388 të LMD-së së vitit 1978, i cili parasheh që *“parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës apo organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi dhe realizimi të kërkesës”*. Ndërsa me nenin 389 të LMD-së së po të njëjtit ligj përcaktohet se *“Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se anulohet masa e siguruar ose e ndërmarrë e ekzekutimit apo e sigurimit”*. Andaj, në rastin konkret procedura përmburimore e iniciuar sipas kreditorit, Kasabank, trashëgimtare ligjore e së cilës është këtu tani paditësja NLB Bank nga Prishtina, kundër debitorëve- J. T., M. A. si dhe H. K., të lejuar sipas Aktvendimit E.nr. 1240/05, në të cilën procedurë është marrë Aktvendim PPP.nr. 834/16 i datës 10.10.2017 me të cilin është aprovuar prapësimi i debitorit M. A. ndërsa Urdhri Përmburimor E.nr.1240/05 i datës 11.01.2006 është shfuqizuar, e i cili aktvendim është bërë i formës së prerë, pasi që edhe paditësja ka pranuar një gjë të tillë, pasi që paditësja nuk ka ushtruar të drejtën e ankesës kundër këtij aktvendimi.

Andaj, në rastin konkret për tu konsideruar ndërprerje e parashkrimit është dashur që kreditori të ketë sukses në procedurën përmburimore dhe jo si në këtë rast që është anuluar aktvendimi mbi lejimin e përmburimit pa u bërë i formës së prerë, që nënkupton se i njëjti është anuluar pa filluar procedura përmburimore dhe duke u mbështetur në këtë dispozitë ligjore vlerësojmë se edhe kur hidhet poshtë padia, edhe kur refuzohet ajo, edhe kur masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmburimit a e sigurimit shpallet e pavlefshme, nuk kemi ndërprerje të parashkrimit. Prandaj, afati i parashkrimit rrjedh edhe gjatë kësaj kohe, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, domethënë afati i parashkrimit rrjedhë në vazhdimësi të pandërprerë.

Gjykatës së Apelit i rezultuar të bazuara pretendimet ankimore të të paditurit M. A. nga Prishtina në lidhje me vendimin mbi shpenzimet procedurale, pasi që gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vendosje si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar përkatësisht vendimit mbi shpenzimet e që është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, ka bërë vlerësim të gabuar të nenit 450 të LPK-së, pasi që kjo dispozitë, në rastin konkret nuk mund të zbatohet pasi që i padituri në fjalën përfundimtare i ka kërkuar shpenzimet e procedurës duke i specifikuar ato. Andaj, gjykata e Apeli vlerëson se të paditurit M. A. i takojnë shpenzimet e procedurës në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili parasheh që “*Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore*”. Andaj, duke qenë se paditëses i është refuzuar kërkesë padia si e pa bazuar dhe në anën tjetër i padituri ka parashtruar kërkesë për shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e Apelit i aprovon të njëjtat ashtu që aktgjykimin e ankimuar në këtë pjesë e ndryshon duke e detyruar paditësen në pagesën e shpenzimeve të procedurës për të paditurin, në lartësi e gjykuar si në dispozitiv nën II të këtij aktgjykimi dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 108,00 euro, për përfaqësim në tri seanca gjyqësore nga 135 euro, shumen prej 405 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 513 euro.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 450 lidhur me nenin 452.1 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9967/2021 datë 12.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v